

Nr. 104 prot
Dt. 20.10.2016.

ARKIV
24.10.16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 5278 Prot.

Tiranë, më 17.10. 2016

UDHËZIM

Nr. 445 datë 17.10. 2016

PËR

NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.138 DATË 03.04.2014 TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR PAJISJEN ME AKT MIRATIMI PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMIT JOJONIZUES”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4 të Ligjit Nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” i ndryshuar dhe pikës 4.10 të VKM-së, Nr.743, datë 16.10.2012, të rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimi jojonizues”;

UDHËZOJ:

1. Pika 1 e udhëzimit Nr.138, datë 03.04.2014 të Ministrit të Shëndetësisë “Për miratimin e tarifave të licensimit për pajisjen me akt miratimi për veprimtarinë me burime të rrezatimit jojonizues” në mbështetje të diskutimeve dhe propozimeve nga KMR, ndryshon si më poshtë vijon:

“Telefonia celulare – Çdo stacion bazë i ri 34.000 Lekë”

Për çdo riaplikim të të njëjtit stacion bazë, të paguhet gjysma e tarifës siç përcaktohet në këtë udhëzues.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET

MINISTRI I SHËNDETËSISË

ILIR BEQAJ

